## ZRRUM, Kosovë

## Opsionet e Politikave tarifore të grumbullimit të Mbeturinave

Tabela pasuese cakton shumë opsione te politikave në dispozicion të ZRRUM për adoptim të deklaruara publikisht si Politikat e Tarifave të grumbullimit të mbeturinave. Ato nuk janë të gjitha reciprokisht të veçanta dhe zgjedhja e një opsioni mund të ndikoj në zgjedhjen e opsioneve tjera diku tjetër në politika.

| Kategoria e gjerë | Nën-kategoria | Opsioni i politikave | Përparësitë | Mangësitë | Implikimet e ZRRUM | Pozitat e preferuara |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Rregullimet institucionale** | **Përgjegjësia për pagesa të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave.**<br>(kush duhet të jetë përgjegjës për pagesën e shërbimeve dhe si duhet të organizohet grumbullimi i financave?) | Sistemi i tashëm i tashëm i kompanive të grumbullimit të mbeturinave që nxjerrin të ardhura drejtpërdrejt nga konsumatorët. | I krijuar dhe nuk ka nevojë për ndryshime | Nuk ka aplikim të masave qe qon në mbledhje të varfër të fitimit<br>Çmimi i pa-efekt, faturimi dhe sistemi i kontrollimit të të ardhurave<br>Rregullativa komplekse | Përgjegjësitë për caktimin e tarifave të mbajtura nga ZRRUM | Kosova duhet të adaptojë modelin konvencional të komunave për grumbullim të mbeturinave shtëpiake dhe duhet të inkurajojë konkurrencën për treg ku mund të konkurrojnë edhe ndërmarrjet në pronësi publike përkundër operatorëve privat.<br>Mbeturinat jo-shtëpiake duhet të jenë të hapura për tregun individual por nevojitet sistem i mbrojtjes nga disa konsumatorë që bien nga sistemi i grumbullimit të mbeturinave, p.sh. konsumatorët rural. |
| | | Transferimi i përgjegjësive të kompanive për grumbullimin e mbeturinave në komuna me kompani për grumbullim të mbeturinave të kontraktuara nga ata (model standard komunal) | Efikasitet Ekonomik dhe operacional.<br>Nxjerrja e të ardhurave më efikas përmes taksave<br>Mundësi për konkurrencë (për treg në bazë periodike)<br>Rregullativa e thjeshtësuar (edhe e eliminuar nëse është subjekt i konkurrencës) | Taksat e ngritura lokale (por e mundur më pak se taksat e tashme për mbeturina) dhe mundësia e pa-favorizimit të përgjegjësive socio-politike nga publiku<br>Rrëmuja institucionale.<br>Ndërmarrjet publike të rirregullohen në nivel të operatorëve privat (mundësisht të privatizuar). | Përgjegjësitë rregullatore për grumbullimin e mbeturinave efektivisht largohen, kufizuar në aktivitetet e monitorimit qeveritar, p.sh. prokurimi i shërbimeve në pajtim me rregullativat dhe praktikat e mira. | |

***Shënime: opsionet pasuese të politikave janë bazuar mbi supozimet se rregullimet institucionale janë të pandryshueshme. Nëse ka ndryshime të mëdha si rekomandohet më lartë, ose ngjashëm, përgjegjësitë rregullatore të ZRRUM mund të jenë shumë të vështira (ose të zhduken) dhe opsionet e politikave tarifore dhe qasja do të ndryshojë ose të zhduket po ashtu.***

| Kategoria e gjerë | Nën-kategoria | Opsioni i politikave | Përparësitë | Mangësitë | Implikimet e ZRRUM | Pozitat e preferuara |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Rregullimet institucionale** (vazhdim) | **Grumbullimi i mbeturinave shtëpiake përkundër atyre jo-shtëpiake.** (a duhet të trajtohen këto dy sektorë shumë ndryshe) | Vazhdimi me rregullimet e tashme ku ZRRUM caktojnë tarifat për grumbullimin e mbeturinave jo-shtëpiake. | Tashmë e krijuar. | Nuk është subjekt i konkurrencës.<br>Mundësi e subvencionimeve të pamjaftueshme për zhvillim.<br>Konkurrence jo e drejtë me shërbimet e tashme të operatorëve privat te konsumatorët shtëpiak.<br>Shtrirje e kufizuar efikase në krahasim me operuesit privat. | Rregullativa komplekse që siguron çmime të paanshme dhe heqjen e subvencionimeve | Nën kornizën ligjore dhe institucionale ku ZRRUM-i është i lidhur me përgatitjen aktuale operative por mund të përfshijë kornizën e plotë të de-rregulluar nën menaxhimin e autoriteteve komunale lidhur me reformay ligjore dhe instituteve të sektorit(shih draft politikën e ZRRUM-it të cekur në PSP). |
| | | Lejon që kompanitë në pronësi publike të grumbullojnë mbeturinat nga konsumatorët jo-shtëpiak në baza komerciale (nuk është e rregulluar nga ZRRUM) | Subjekt i konkurrencës.<br>Çmime efikase. | Kërkon ristrukturim për të siguruar konkurrencën e lirë dhe të drejtë (konto unazore etj.)<br>Kërkohen investime të reja për të siguruar ndarjen e mbeturinave shtëpiake dhe jo-shtëpiake. | Rregullime të rëndësishme auditivi për të siguruar ndarje të qartë të kostos jo-shtëpiake dhe të fitimit.<br>Mbikëqyrje të procesit të konkurrimit. | |
| | | Largon përgjegjësitë e grumbullimit të mbeturinave jo-shtëpiake nga kompanitë publike, dmth. Vetëm shërbimet e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake | Lejon konkurrencë të hapur për aktivitete të grumbullimit të mbeturinave jo-shtëpiake. | Jo-praktike dhe jo-efikase duke detyruar dy apo më shumë operues të dyfishojnë raundin e grumbullimit të mbeturinave.<br>Ndërmarrjet publike mund të zbatohen nëse kufizohen në grumbullim të mbeturinave shtëpiake. | Thjeshtë për të rregulluar nëse fokusohemi vetëm në grumbullimin e mbeturinave shtëpiake. | |

| Kategoria e gjerë | Nën-kategoria | Opsioni i politikave | Përparësitë | Mangësitë | Implikimet e ZRRUM | Pozitat e preferuara |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Drejtësia Sociale** | **Roli i ndërmarrjeve në pronësi publike me përgjegjësi sociale.**<br>(në cilën masë është përgjegjësia e rishpërndarjes sociale të pasurisë bie mbi ndërmarrjet në pronësi publike dhe në cilën masë ka rol qeveria? | Qeveria të jetë përgjegjëse për të siguruar përkrahje financiare të mos-përparësive ekonomike | 2004/49 10.1 (f) përcakton përgjegjësitë e qeverisë dhe institucioneve lokale për të siguruar përkrahje.<br>Mbron integritetin financiar të ndërmarrjeve në pronësi publike.<br>Ekonomikisht efikase.<br>Me përkrahje të tarifave më të varfra mund të lejohet ngritja e lartësisë maksimale të dispozicionit të konsumatorëve të mbetur drejtues përkundër rigjenerimit të kostos. | Imponon detyrime financiare në institucionet qeveritare dhe lokale që duhet të plotësohen për nga aspekti fiskal. | Thjeshtë për të rregulluar. | Qeveria të merr përgjegjësitë për masa te përkrahjes financiare të mos-përparësive ekonomike kështu tu lejohet ndërmarrjeve publike të veprojnë në bazë komerciale dhe ekonomike.<br>Qeveria vendos politikat e jo ZRRUM. |
| | | Ndërmarrjet në pronësi publike sigurojnë përkrahje financiare të mos-përparësive ekonomike. | Lehtëson barrën financiare të qeverisë. | Minon integritetin financiar të ndërmarrjeve publike.<br>Krijon shtrembërim të tregut dhe është ekonomikisht joefikas (pengon subvencionet).<br>Dekurajon konkurrencën dhe investimet në sektor. | Rregullativa komplekse në përcaktim të shkallës në të cilën mund të kaloj mekanizmi i subvencionimit dhe të aplikohet dhe si të monitorohet dhe aplikohet.<br>Vendimet e ZRRUM cenohen të ndryshohen. | |
| **Drejtësia Sociale** (vazhdim) | **Uniformimi i tarifave**<br>(në cilën masë duhet tarifat të uniformohen sipas regjionit?) | Tarifa uniforme përmes rajonit të definuar të furnizimit të ndërmarrjeve në pronësi publike. | Perceptohet si e drejtë. | Ekonomikisht jo-efikas në ato fusha ku fitimi nuk mund të mbuloj koston e furnizimit ndërsa në tjerat fitimet mund të tejkalojnë koston e furnizimit. | Thjesht të rregullohet bazuar në koston e përgjithshme operuese dhe fitimin.<br>Kërkohen imputo të mëtejme rregullatore për të siguruar obligimet e shërbimeve të kënaqshme dhe që fushat jo-profitabile të mos diskriminohen pa të drejtë. | Tarifat duhet të përcaktohen në bazë të tarifave të njëjta në fushat e shërbimeve të ndërmarrjeve në pronësi publike. |
| | | Pa uniformitet të tarifave dhe në secilin qytet individual ose rajon mund të ndajnë koston e tarifave pasqyruese. | Ekonomikisht efikase me tarifa reflektive të kostos aktuale. | Perceptimi social i padrejtësive.<br>Kontabilitet kompleks, monitorim dhe sistem raportimi për të monitoruar koston e një qyteti në bazë të qytetit. | Numri i skemave dhe qyteteve mund të imponoj një punë të lartë rregullatore në ZRRUM.<br>Procedurat e përcaktimit kompleks të tarifave dhe cenueshmëria e ndryshimit. | |

| Kategoria e gjerë | Nën-kategoria | Opsioni i politikave | Përparësitë | Mangësitë | Implikimet e ZRRUM | Pozitat e preferuara |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Drejtësia Sociale** (vazhdim) | **Tarifa te ndryshme për nivele të ndryshme të shërbimeve**<br>(nëse lejon struktura e tarifave për tarifa të ndryshme për shërbime të konsumatorëve të shërbyer nga kontejnerët komunal se sa të atyre që mbeturinat u mblidhen individualisht) | Tarifa të ndara për shërbime të grumbullimit komunal dhe individual | Sistemi i tashëm i tarifave dhe rregullativave edhe pse nuk aplikohet.<br>Kosto reflektive.<br>Zbaton tarifa më të ulëta për ekonomitë shtëpiake të varfra (në përgjithësi konsumator komunal)<br>Politikisht lehtë të shitet te publiku. | Rregullativa shtesë në përcaktim të pagesave të drejta.<br>Do të aplikoj çmime më të larta për shtëpitë që kanë shërbime individuale të mbledhjes së mbeturinave. | Përpjekje rregullatore në përcaktim të çmimeve të drejta. | Tarifat duhet të ndajnë shërbimet komunale nga shërbimet individuale të jenë kosto reflektive në përputhje me rregullativat e tashme. |
| | | Tarifa uniforme pa marrë parasysh tipin e shërbimeve të mbledhjes. | Më efikase.<br>Nuk diskriminon përkundër lidhjeve të përbashkëta.<br>Nuk inkurajon (aq shumë) investimet personale në higjienën e përmirësuar, p.sh. pastrimi i tualetit.<br>Mund të inkurajojë më shumë investime në rajonet e varfra ku kthimet janë përmirësuar. | Nuk ka kosto reflektive<br>Nuk aplikon tarifë më të ultë për familjet më të varfra. | Rregullativa komplekse. | |
| | **Çmime fikse – mbledhja e mbeturinave shtëpiake**<br>(nëse **mbledhja e mbeturinave shtëpiake** bazohet mbi një pagesë mujore për ekonomi shtëpiake) | Vetëm një opsion është në dispozicion pasi faturimi sipas masës apo vëllimit nuk është i mundur. | Thjeshtë | Kosto varet nga pesha dhe/apo vëllimi dhe është vështirë të përcaktohet pagesa adekuate për ekonomi shtëpiake. | Rregullativa kërkohet të përcaktoj nivelin adekuat të pagesës. | Mbajnë sistemin e tashëm të pagave fikse për ekonomi shtëpiake për muaj |
| | **Pagesa fikse dhe variabile – të mbledhjes së mbeturinave jo-shtëpiake**<br>(nëse grumbullimi i mbeturinave jo-shtëpiake paguhet në bazë të një page fikse të thjeshtë, në vend të pagesës sipas peshës apo zbrazjeve) | Vetëm një opsion është në dispozicion tash sepse shërbimet e tashme komunale për faturim të shërbimeve jo-shtëpiake në bazë mujore ndërsa ata konsumatorë me kontejner individual tariforen në bazë të secilës zbrazje (rata varet nga madhësia e kontejnerit) | Thjeshtë<br>Për konsumator me kontejner individual çmimet mund të jenë me kosto më shumë reflektive. | Kosto varet nga pesha dhe/apo vëllimi dhe është vështirë të përcaktohet pagesa adekuate mujore aty ku zbatohet. | Rregullativa kërkohet të përcaktoj nivelin adekuat të pagesës. | Mbajnë sistemin e tashëm të një sistemi të përzier të pagesës. |

| Kategoria e gjerë | Nën-kategoria | Opsioni i politikave | Përparësitë | Mangësitë | Implikimet e ZRRUM | Pozitat e preferuara |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Rigjenerim i plotë i kostos.** | **Definicion** (çka kuptohet me rigjenerimin e plotë të kostos) | Definicionet llogaritëse në bazë të kostos si është definuar në termet e pastra llogaritëse barazuar me fitimin e parave të gatshme plus një zbritje e drejtë për kthim të kapitalit. | Thjeshtë të përcaktohet bazuar në rregullat strikte por konvencionale të llogari mbajtjes. Atraktive për investime në sektorin privat | Çrregullime të vogla për shkak të efektit të inflacionit. | Inpute të thjeshta rregullative por që duhet të bëhen çdo vjet. | Natyra afatshkurtër e biznesit përfshirë asetet jetë shkurtëra e bën metodën e kontabilitetit definicion të zbatueshëm të rigjenerimit të kostos dhe duhet të adaptohet në pajtim me standardet e kontabilitetit të Kosovës apo ato Ndërkombëtare Kjo do të kërkojë ndryshime në rregullën aktuale të ZRRUM-it.. |
| | | Fitimi i parave të gatshme të mjaftueshme për shërbimet komunale që të s financojnë aktivitetet e tyre në pajtim me kualitetin e tyre dhe obligimet e shërbimeve dhe një zbritje për kthim të kapitalit. | Nil | Komplekse pa nevojë | Metoda të përcaktimit të tarifave komplekse | |
| | **Koha bazuar në rigjenerim të kostos (**cila është koha e arritjes së plotë të rigjenerimit të kostos ?) | Rigjenerim të kostos afat shkurtë (vjetore) | Eliminim i menjëhershëm i subvencionimit Atraktive për investitorë Në pajtim me definicionet e rekomanduara për rigjenerimin e kostos | Mund të rezultojë në tronditje të çmimeve Rezultate në financimin e jo-efikasitetit ekzistues. | Thjeshtë të rregullohet. | Grumbullimi i mbeturinave në një treg ku ka konkurrencë duhet të operojë në rigjenerim të plotë e të menjëhershëm të kostos. Shtyrja e rigjenerimit të kostos është çrregullim i tregut dhe nuk do të inkurajojë konkurrencën. |
| | | Mesatare kah afatgjata për rigjenerim të kostos p.sh. 5 deri 10 vjet. | Zbut tarifat në rata uniforme të afërta (ose që ngritët pak) duke lehtësuar pengesat e mundësive. Jep kohë për efikasitet të përmirësuar që duhet arritur. Eliminon tronditjet e çmimeve. | Natyra afatshkurtër e biznesit nuk lejon vetvetiu programet afatgjata të rigjenerimit të kostos. Anti-konkurrencë. Zvogëlon profitabilitetin në vitete e hershme (humbjet mund të raportohen) me profitabilitet me të lartë në vitet e mëvonshme. Rrezik i ndikimit të politikës që reziston fitimet e larta në vitet e mëvonshme nevojitet të zëvendësojë humbjet e mëhershme. | Rregullativa më komplekse dhe subjekt i ndikimit të politikës. | |
| | **Pritet efikasitet përfshirë edhe performancën e mbledhjes së fitimeve.** (si duhet të përcaktohen përmirësimet e pritura ne efikasitet?) | Efikasitet operimi dhe të kapitalit dhe pritje të caktuara nga ZRRUM dhe të përfshira në përcaktim të tarifave. | Promovon përmirësimin e efikasitetit në ndërmarrjet publike dhe te operatorët. | Mund të dëmtoj gjendjen financiare të ndërmarrjeve publike nëse caqet efikase janë të caktuara shumë lartë e nuk mund të arrihen. Nuk janë adekuate për tregun konkurrues. | Gjykime profesionale të përcaktimit të caqeve të efikasitetit të arsyeshëm. | ZRRUM duhet të caktojë një sasi të kufizuar të pritjes së përmirësimit të efikasitetit përderisa ato janë të krahasueshme në treg në kriteret e performancës. |

| Kategoria e gjerë | Nën-kategoria | Opsioni i politikave | Përparësitë | Mangësitë | Implikimet e ZRRUM | Pozitat e preferuara |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Ndërmarrjet publike të caktojnë pritjet e efikasitetit. | Rrezik i ndërmarrjeve publike.<br>Proces konkurrence | Mund të rezultojë në pritje të ulta të rezultateve efikase në tarifa më të larta se që do të ishin. | Angazhim i kufizuar rregullativ i ZRRUM. | |
| **Rigjenerim i plotë i kostos. (vazhdim)** | **Investimet kapitale**<br>(si duhet të rigjenerohen **Investimet kapitale)** | Rigjenerohen çdo vjet përmes amortizimit historik të kostos | Supozon një definicion kontabiliteti të rigjenerimit të plotë të kostos<br>E pranueshme për asetet afatshkurtra si përdoren për biznesin e mbledhjes së mbeturinave<br>Thjeshtë të përcaktohet. | Pengesa të vogla për efekte inflacioni | Kalkulimi i amortizimit është i thjeshtë.<br>Dilema se të lejohet apo jo rigjenerimi i pagesës së prapambetur të amortizimit të viteve të mëparshme. | Kosto të thjeshtë historike të amortizimit për asete konsiderohet të jetë adekuate dhe mekanizëm praktik për kthim të kapitalit. |
| | | Rigjenerohen përmes tarifave vjetore me amortizim të tashëm të kostos | Masa adekuate për mirëmbajtje të kapitalit të përfshirë në tarifa | Pa nevojë e komplikuar për asete afatshkurtra | Kalkulime të komplikuara për rregullimet e inflacionit.<br>Dilema se të lejohet apo jo rigjenerimi i pagesës së prapambetur të amortizimit të viteve të mëparshme. | |
| | | Amortizimi i rigjeneruar në bazë afat gjatë përmes kalkulimit afatgjatë të rigjenerimit të kostos. | Zbut tarifat në një ratë uniforme (ose ratë që ngrihet pak) duke lehtësuar pengesat e mundësive.<br>Eliminon tronditjet e çmimeve. | Nuk përshtatet në tregun konkurrues.<br>Nuk përshtatet për modelet e biznesit afatshkurtër si është grumbullimi i mbeturinave. | Zbritja e komplikuar e kalkulimit të qarkullimit të parave me pak ose pa përfitim nga qasja e thjeshtë llogaritare. | |
| | **Kreditë dhe asetet e dhuruara**<br>(si duhet ZRRUM të trajtoj asetet e financuara nga kreditë dhe kreditë e lehta) | Konsideroj tërë asetet të trajtohen njejtë pa marrë parasysh si financohen ato. | Thjeshtë të përcaktohet.<br>U përshtatet tregjeve konkurruese. | Me efikasitet u jep kthimin e ndërmarrjeve publike për një investim që nuk është bërë, duke rezultuar me tarifa më të larta se që do të ishin. | ZRRUM mund të jetë subjekt i sfidave nga lejimi i kthimit më të madh se sa duhet të jetë. | Zgjidhja e qasjes për qeverinë dhe pozita e ZRRUM lidhur me konkurrencën në sektor.<br>Nëse nuk inkurajohet konkurrenca atëherë mos merrni parasysh amortizimin ose asetet e dhuruara por nëse konkurrenca inkurajohet atëherë duhet të hiqet pengesa e padrejtë. |
| | | Mos llogarit amortizimin për asetet e dhuruara ose apliko teknika barazimi për balancimin e amortizimit përkundër vlerës së kredisë që trajtohet si të ardhura mbi jetën e aseteve. | Krijon një bazë të drejtë për përcaktimin e kthimit të bazuar në kapital mbi investime e bëra nga etniteti operues.<br>Ul tarifat. | Konkurrencë jo e drejtë ku konkurruesit nxjerrin financa përmes burimeve të veta ose huazimeve komerciale. | Më pak i hapur për sfida. | |

| Kategoria e gjerë | Nën-kategoria | Opsioni i politikave | Përparësitë | Mangësitë | Implikimet e ZRRUM | Pozitat e preferuara |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Struktura e kapitalit.** | **Principet e përgjithshme**<br>(a duhet ZRRUM të konsideroj strukturën e kapitalit të shërbimeve komunale në procesin e përcaktimit të tarifave) | ZRRUM të merr parasysh strukturën e kapitalit të ndërmarrjeve publike në përcaktimin e tarifave, dmth. Të përfshij borxhet e kamatave dhe ri-pagimin e kapitalit tarifat me kthim në drejtësi të përcaktuar nga ZRRUM. | Mbron pozitën e ndërmarrjeve publike sa i përket rrezikut dhe qarkullimit të parave. | Përkundër teorisë ekonomike konvencionale se struktura e kapitalit nuk ka lidhje direkte me performancën e biznesit.<br>Subjekt i luhatjes së çmimit nëse ndryshon struktura e kapital it. | Analiza financiare komplekse. | Në bazë të asaj se ndërmarrjet publike duhet të kërkojnë rigjenerim të plotë e të shpejtë të kostos në bazë konkurrence, ZRRUM duhet të konsideroj strukturën e kapitalit të shërbimeve komunale si çështje për menagjimin e tyre e jo si brengë e rregullatorit.. Sidoqoftë ZRRUM-i duhet me pasë interesin në strukturën kapitale lidhur me rrjedhën e parasë. |
| | | ZRRUM të merr parasysh strukturën e kapitalit si një çështje e brendshme e ndërmarrjeve në pronësi publike dmth për . ZRRUM të përcaktoj një kthim të përafërt të tërë kapitalit nga e cila ndërmarrjet publike mund të menaxhojnë shërbimin e borxheve të veta. | Në pajtim me terit konvencionale ekonomike se struktura e kapitalit nuk ka lidhje në performancë operative të biznesit (pos taksave).<br>Promovon stabilitetin e çmimit pa marrë parasysh variacionet në strukturën e kapitalit. | Ndërmarrjet publike i ekspozohen rrezikut lidhur me huazimin. | Analiza financiare e thjeshtësuar. | |
| **Vlera e kapitalit dhe kthimi në kapital.** | **Definicioni i vlerës së kapitalit mbi të cilën mund të fitohet kthimi.**<br><br>(cili është pozicioni i ZRRUM sa i përket vlerës kapitale rregullatore të ndërmarrjeve publike?) | Vlera e kapitalit e përcaktuar si vlerë e librit të kontabilitetit të aseteve. | Thjeshtë të përcaktohet bazuar në deklarata financiare (regjistër asetesh) | Pengesa të vogla për efekte inflacioni<br>Mund të përfshij asetet e dhuruara ose të trashëguara dhe mund të jetë jo adekuat të lejoj kthim në kapital për asete të tilla. | Duhet të lejojë kalkulimin kompleks të përcaktimit të kthimit adekuat në kapital që lejon një përzierje të burimeve të fondeve. | ZRRUM duhet të caktoj vlerën e kapitalit bazuar në investimet e bëra nga ndërmarrjet publike prej burimeve të tyre financiare.<br>Sido qoftë nëse qeveria ia heq pushtetin operacioneve të veta një pikëpamje e ndryshme në vlerën e kapitalit do të kërkohet duke reflektuar çmimin e blerjes së biznesit. |
| | | Vlera e kapitalit e përcaktuar si vlerë e librit të kontabilitetit të aseteve e rregulluar për inflacion. | Nil | I komplikuar pa nevojë për biznese të modelit të mbledhjes së mbeturinave.<br>Mund të përfshij asetet e dhuruara ose të trashëguara dhe mund të jetë jo adekuat të lejoj kthim në kapital për asete të tilla. | Si lartë. | |
| | | Vlera e kapitalit e përcaktuar në bazë të vlerës së investimeve të bëra burimet vetanake financiare të KLMC. | Dorëzon tarifa më të ulëta se sa metodat tjera.<br>Siguron një bazë për vlerë të drejtë të aseteve që reflekton koston reale të investimeve në operator.<br>Përcakton kthimin e lejuar në kapital të thjeshtësuar. | Rregulla të qarta kontabiliteti nevojiten të sigurojnë ndarjen e aseteve. | Posa të caktohet është lehtë për rregullatorin të mbaj një regjistër vlerave kapitale rregullatore të biznesit. | |

| Kategoria e gjerë | Nën-kategoria | Opsioni i politikave | Përparësitë | Mangësitë | Implikimet e ZRRUM | Pozitat e preferuara |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Vlera e kapitalit dhe kthimi ne kapital.**<br>(vazhdim) | **Kthimi ne kapital**<br>(cili është pozicioni i ZRRUM sa i përket kthimit të kapitalit?) | ZRRUM të mos merr parasysh kthimin e kapitalit si pjesë e lejueshme e tarifave. | Minimizon tarifat.<br>Thjeshtë në atë se nuk ka çështje reale me përcaktimin e vlerës kapitale rregullatore. | Nuk mbulon koston e borxheve (kamatën)<br>S'ka financa në dispozicion për përmirësim të shërbimeve<br>Nuk mund të financoj riparimin e borxhit kryesor.<br>Konkurrencë e padrejtë. | Derisa në pronësi shtetërore qeveria mund të zgjedh të mos pres kthim në kapital dhe për këtë ZRRUM mund të obligohet të adoptoj këtë model. | Kthimi në kapital duhet të bazohet mbi pritjet e tregut për kthim në kapital duke përdorur mjetet ekonomike si CAPM. |
| | | ZRRUM të përcaktoj kthimin në kapital në bazë të pritjeve të tregut në shfrytëzimin e mjeteve ekonomike si është Modeli i çmimores së kapitalit të aseteve (CAPM). | Atraktive për investime të brendshme e të jashtme private në sektor.<br>Promovon konkurrencë | Implikime të kundërta.<br>Duhet të përdoren vetëm në sektorin e investimeve private, dmth. Jo adekuate të priten kthime në kapital në sektorin privat me nivel të kthimit në nivel të jo-efikasitetit të sektorit publik. | Rregulla komplekse të përcaktimit të çka është kthim i drejtë në kapital por është e mundur të merret udhëheqja nga operator të ngjashëm të sektorit privat tjetër kund në botë. | |
| | | ZRRUM të caktoj një kthim në kapital bazuar në kërkesat e qarkullimit minimal të parave. | Minimizon tarifat.<br>Atraktive për investime të qeverisë dhe të donatorëve në sektor. | Jo atraktive për investime të brendshme dhe të jashtme private në sektor.<br>Konkurrencë e padrejtë. | Mund të jenë jo adekuate për modelin e tashëm të ndërmarrjeve publike. Qeveria si përfitues kryesor mund të theksoj pozitën e saj në lidhje me atë se çka kërkohet për kthim në kapital. | |
| | **Kthimi ne kapital dhe taksat**<br>(cili është pozicioni i ZRRUM sa i përket taksave?) | Të përcaktoj tarifat në bazë të 'post taks' kthim në kapital. | Lehtë të përcaktoj pritjet e tregut për kthim në kapital në një 'post taks' bazë si kundër një'pre-taksë' baze.. | Kalkulimi i obligimeve të taksave që përpara përcaktimit të tarifave. | Nil | Nuk ka nevojë të konsiderohet çështja e taksave përveç që të futet vlera e taksave në koston bazë nën rregullimet e tashme institucionale. |
| | | Të përcaktoj tarifat në bazë të 'post taks' kthim në kapital. | Thjeshtë të llogaritet pa nevojë të llogaritjes së obligimeve të taksave që më parë. | Përcaktimi i pritjeve të tregut për kthim 'pre-taksë' në kapital më kompleks. | Nil | |

| Kategoria e gjerë | Nën-kategoria | Opsioni i politikave | Përparësitë | Mangësitë | Implikimet e ZRRUM | Pozitat e preferuara |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Procesi** | **Periudhat e rishikimit**<br>(sa kohë duhet të ketë mes rishikimit të tarifave kryesore?) | ZRRUM të rishikoj tarifat çdo vjet. | Siguron që tarifat të ndjekin koston.<br>Promovon konkurrencën. | Pa stimulim për efikasitet të përmirësuar pasi çfarëdo përfitimi do të humb në rishikimin e ardhshëm.<br>Rezultate në tarifa të larta në vitet e hershme me tarifa që bien në vitet tjera.<br>Jo-atraktive për investitorë privat. | Thjeshtë të rregullohen. | Për vitin 2007/8 tarifat duhet të përcaktohen në bazë vjetore në të cilën kohë politikat tarifore mund të zhvillohen me një komplet rregullash që mund të lejojnë përudha më të gjata mes rishikimeve.<br>Nëse tarifat që përdoren gjatë mund të përcaktohen periodikisht në bazë të tenderimit dhe të shërbimeve tjera të metodave të prokurimit. |
| | | ZRRUM të rishikoj tarifat në mënyrë periodike (të themi çdo 3 apo 5 vjet) me lejim të rregullimeve automatike për inflacion dhe faktorë tjerë. | Stimulojnë profit me efikasitet të përmirësuar<br>Tarifa të zbutura e mundur.<br>Atraktive për investime. | Ndërmarrjet në pronësi publike mund të shkojnë më tej me fitim më të lartë se që duhet. | ZRRUM të aplikoj metoda më komplekse për përcaktim të tarifave. | |